



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

VENDIM
Nr.242, datë 03/09/2012

“Për
disa ndryshime në rregulloren e caktimit të shpenzimeve për ndjekjen e
procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita	MILO (LATI)	Kryetare
Znj. Rezana	KONOMI	Zv/Kryetare
Znj. Servete	GRUDA	Anëtare
Z. Koço	BROKA	Anëtar
Znj.Iva	ZAJMI	Anëtare

Në mbledhjen e tij të datës 03/09/2012, në bazë të nenit 24, germa c, i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit,

VENDOSI:

Përmbajtja e Nenit 1 të Rregullores “Për caktimin e shpenzimeve dhe ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”, miratuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 10 , date 29. 06.2004, ndryshuar me Vendimin nr 167, date 21.12.2010, ndryshohet si vijon:

“1.Tërheqja e “Formularit të njoftimit të përqëndrimit”, nga ndërmarrjet pjesmarrëse të përcaktuara në nenin 12, të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të cilat bashkohen, përftojnë kontrollin, si dhe për rastet kur pjesa e ndërmarrjes preket nga transaksioni i kryer) bëhet kundrejt pagesave me vlerë:

- a) 7.500 Lekë për ndërmarrjet që përfitojnë kontrollin dhe që në tregun e brendshëm kanë xhiro vjetore nga 200 milionë lekë deri në 1 miliardë lekë;
- b) 15.000 Lekë për ndërmarrjet që përfitojnë kontrollin dhe që në tregun e brendshëm kanë xhiro vjetore më shumë se 1 miliardë lekë.

2. Autorizimi “Për realizimin e përkohshëm të përqëndrimit” që jepet nga Komisioni i Konkurrencës në bazë të kërkesës së ndërmarrjeve pjesmarrëse, në përputhje me nenin 60, pika 1, të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” do të jepen kundrejt pagesave me vlerë:

- a) 150. 000 Lekë për ndërmarrjet që përfitojnë kontrollin dhe që në tregun e brendshëm kanë xhiro vjetore nga 200 milionë lekë deri në 1 miliardë lekë;
- b) 300.000 Lekë për ndërmarrjet që përfitojnë kontrollin dhe që në tregun e brendshëm kanë xhiro vjetore më shumë se 1 miliardë lekë.
3. Autorizimi “Për realizimin e përqëndrimit”, që jepet nga Komisioni, në përputhje me nenin 56, të Ligjit merret kundrejt pagesës me vlerë:
- a) 250.000 Lekë për për ndërmarrjet që përfitojnë kontrollin dhe që në tregun e brendshëm kanë xhiro vjetore nga 200 milionë lekë deri në 1 miliardë lekë;
- b) 500.000 Lekë për ndërmarrjet që përfitojnë kontrollin dhe që në tregun e brendshëm kanë xhiro vjetore më shumë se 1 miliardë lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Rezana KONOMI

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Zv/Kryetare

Anëtare

Anëtar

Anëtare

Lindita MILO (LATI)

KRYETARE